



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dostiguar Punlyeto/Prodato Received/Delivety	25-01-2022	3	viti god year
Organ /Rrësia Organ /Jedinita Org./Unit	Rr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTK	798/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1149/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërje nga: Malsore Gashi - Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1149/2022 të datës 12.12.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1149/2022 e datës 12.12.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.39/2022 i datës 24.11.2022, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje referuar si SKPK), më datën 28.09.2022 ka shpallur konkurs të jashtëm për pozitën e punës *Bashkëpunëtor profesional*, dy (2) pozita, në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, i cili konkurs sipas shkrësive të lëndës ishte i hapur për aplikim nga data 28.09.2022 deri me datën 12.10.2022.

Në listën e ngushtë të datës 19.10.2022 të publikuar nga SKPK janë përfshirë pesëmbëdhjetë (15) kandidatë, ndër ta edhe ankuesi i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit lidhur me pozitën përkatëse të punës, ndërsa sipas Njoftimit për përzgjedhje përfundimtare të datës 07.11.2022 si kandidatë të suksesshëm lidhur me këtë pozitë të punës janë shpallur _____ me gjithsejtë 86.5 pikë dhe _____ me gjithsejtë 67.8 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin për përzgjedhjen përfundimtare, me datën 16.11.2022 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, me pretendimet ankimore për shkelje procedurale, shkelje të rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në

Shërbimin Civil, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.39/2022 të datës 24.11.2022 refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 16.11.2022, duke lënë në fuqi Njoftimin e datës 07.11.2022 lidhur me kandidatin e suksesshëm të lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në SKPK.

Kundër Vendimit KA.Nr.39/2022 të datës 24.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKKK-së, ankuesi brenda afatit ligjor me datën 12.12.2022 parashtron ankesë me numër të protokollit 7880/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1149/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 15.12.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 8139/2022 tek SKPK, ndërsa me datën 28.12.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 7880/2022 të datës 12.12.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 1989/2022 të datës 24.11.2022 nga komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të datës 07.11.2022; Listën me rezultatet e testimit me shkrim të datës 28.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 28.12.2022 nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës; Konkursin e datës 28.09.2022; Vendimin me numër Nr.1711/2022 të datës 17.10.2022 për themelimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil; Deklaratën me numër Nr.1714/2022 të datës 17.10.2022 lidhur me formimin e komisionit; Miratimin me numër Nr.1715/2022 të datës 17.10.2022 lidhur me formimin e komisionit; Akt emërimit me numër DBNJ/DPSKPK-1026/2021 të datës 09.12.2021 për _____, Vendimin me numër Nr.1317/2022 të datës 03.08.2022; Akt emërimit me numër protokollit ZBNJ/DP-031/2014 të datës 01.04.2014 për _____ Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 09.03.2017 për _____ Akt emërimit me numër protokollit ZBNJ/DP-065/2013 të datës 04.09.2013 për _____ Akt emërimit me numër DBNJ/DPSKPK/1190/2022 të datës 23.05.2022 për _____ Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Njoftimin e datës 19.10.2022 lidhur me kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës të datës 03.11.2022; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të intervistës të datës 03.11.2022; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim të datës 26.10.2022; Listën me vlerësimet e kandidatëve pjesëmarrës nga anëtarët e komisionit vlerësues; Rezultatet e testit me shkrim të datës 28.10.2022; Ankesën e ankuesit të datës 16.11.2022 e parashtruar tek KZKA; Vendimin me numër Nr.1989/2022 të datës 24.11.2022 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së; Aplikacionin për punësim me numër 1655 të datës 12.10.2022 të ankuesit _____ së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë të punës, certifikatën nga gjykata, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatat e trajnimeve dhe të provimit të jurisprudence; Aplikacionin për punësim me numër 1642 të datës 11.10.2022 të kandidatit _____ së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë të punës, certifikatën nga gjykata, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatat e trajnimeve dhe të provimit të jurisprudence; Testet me shkrim të kandidatëve aplikues të datës 24.10.2022 së bashku me deklaratat e kandidatëve aplikues të datës 24.10.2022 lidhur me

deklarimin e mos ekzistimit të konfliktit të interesit si dhe çelësin me përgjigjet e sakta të testimit me shkrim të datës 24.10.2022.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresat të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar me datë 12.12.2022 pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase sipas të njëjtit testi me shkrim nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga Komisioni Përzgjedhës, duke ju referuar kështu pjesës së tretë të testit me shkrim dhe rrjedhimisht i njëjti pretendon se ka pasur një epërsi të pikëve sa i përket kandidatës së dytë të përzgjedhur

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se për pozitën e punës *Bashkëpunëtor profesional, në Prokurorinë Themelore në Prishtinë*, si kritere themelore të përcaktuar kanë qenë: Përgatitja profesionale dhe kualifikimi: *Diplomë universitare, Fakulteti Juridik, Provimi i Jurisprudencës, Përvoja e punës: Së paku 3 vite përvojë pune profesionale*. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës është konstatuar se kandidatet e përzgjedhur kanë plotësuar kriteret e konkursit, ngase Kolegji i Këshillit ka gjetur se kandidati i përzgjedhur me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me numër 2572 të datës 12.05.2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se i njëjti me datën 24.12.2013 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe me këtë rast ka marrë titullin Jurist i diplomuar-Bachelor, ndërsa sipas Certifikatës me numër Nr.76/2017 të datës 13.03.2017 të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, rrjedh se i njëjti ka përfunduar provimin e Jurisprudencës me datën 31.01.2017. Ndërlidhur me përvojën e punës i kandidati i përzgjedhur ka dorëzuar: Certifikatën me numër Nr.03/1558 të datës 08.12.2015 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një (1) viti nga data 24.11.2014 deri më 23.11.2015 në Gjykatën Themelore të Pejës - Dega në Suharekë, si dhe Vërtetimin me numër Vr.Nr.1171/2022 të datës 05.10.2022 të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, sipas së cilës dëshmohet se i njëjti sipas Vendimit Nr.903-1/17 të datës 27.07.2017 ushtron profesionin e avokatit në zyrën e tij në Suharekë. Ndërsa kandidatja e dytë e përzgjedhur me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me numër 2659 të datës 10.07.2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se me datën 21.09.2012 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe me këtë rast ka marrë titullin Jurist i diplomuar-Bachelor, ndërsa sipas Diplomës me numër Nr.2034 të datës 12.12.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dëshmohet se me datën 19.09.2018 ka përfunduar studimet master pranë Fakultetit Juridik, në drejtimin Penal dhe si rrjedhojë ka marrë titullin LL.M (Master) në të drejtën Penale, ndërsa sipas Certifikatës me numër Nr.134/2019 të datës 13.05.2019 të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, rrjedh se e njëjta ka përfunduar provimin e Jurisprudencës me datën 13.05.2019. Ndërlidhur me përvojën e punës kandidatja e përzgjedhur ka dorëzuar Certifikatën me numër Nr.03/2318 të datës 12.09.2014 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me të cilën dëshmohet se e njëjta ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një (1) viti nga data 02.09.2013 deri më 01.09.2014 në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, Vërtetimin me numër Vr.Nr.1225/2022 të datës 11.10.2022 të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës sipas së cilës dëshmohet se e njëjta sipas Vendimit Nr.1549/19 të datës 19.01.2020 ushtron profesionin e avokates në zyrën e saj në Prishtinë. Kështu që duke ju referuar provave të administruara si me lartë Andaj, Kolegji i Këshilli konstaton se të dy kandidatet e përzgjedhur i kanë plotësuar kriteret e konkursit në kuptim të kualifikimit dhe përvojës së kërkuar të punës, dhe si rrjedhojë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin



përfshirjes së tyre në listën e shkurtër ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 ku përcaktohet se: 1. Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1 Arsimin dhe kualifikimin profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës.

Kolegji i Këshillit bazuar në provat e lëndës, respektivisht formularin e datës 26.10.2022, 28.10.2022 dhe 03.11.2022 lidhur me përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë ka gjetur se kandidati i përzgjedhur në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka mbledhur gjithsejtë 86.5 pikë, kandidatja e përzgjedhur ka mbledhur gjithsejtë 67.8, ndërsa ankuesi në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka mbledhur gjithsejtë 67.2 pikë, nga rrjedh se kandidatet e përzgjedhur kanë arritur me se shumti pikë duke u renditur me numër rendor 1 dhe 2 në listën e kandidateve të suksesshëm. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i çelësit të testit me shkrim është konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka vepruar në pajtim me nenin 37, 38 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe nuk është vërejtur ndonjë shkelje procedurale ngase të gjithë kandidatëve i është dhënë mundësia e barabartë për t'iu nënshtruar të gjitha procedurave të rekrutimit, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se testi me shkrim nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga Komisioni Përzgjedhës, duke ju referuar kështu pjesës së tretë të testit me shkrim, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se testi me shkrim për pozitën *Bashkëpunëtor Profesional* të mbajtur me datë 24.10.2022 ka qenë i përpiluar në pajtueshmëri me nenin 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi që pjesa e parë e testit me shkrim që ka të bëjë me njohuritë e përgjithshme është përberë nga tre (3) ese, pjesa e dytë e testit me shkrim që ka të bëjë me aftësitë e përgjithshme dhe të personalitetit, është përberë nga dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta, si dhe pjesa e tretë e testit me shkrim që ka të bëjë me njohuritë e vendit të punës është përberë nga gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje, prej tyre gjysma me përgjigje të shumëfishta dhe gjysma në formë eseje të shkurtra. Rrjedhimisht ankuesi në testin me shkrim ka arritur të grumbulloi 67 pikë, ndërsa kandidatët e përzgjedhur kanë arritur të grumbullojnë, si vijon:

89 pikë ndërsa dhe 58 pikë, dhe gjatë analizimit të testit me shkrim të ankuesit dhe të kandidatëve të përzgjedhur nuk është vërejtur ndonjë parregullsi e cila mund ta ketë favorizuar respektivisht dëmtuar ndonjërin nga kandidatët në procedurë rekrutimi, kështu që në rrethanat e rastit konkret Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nenin 36 paragrafit 2, ku përcaktohet se: *Kandidatët të cilët kalojnë me sukses testin me shkrim ose arrijnë të mbledhin 50% të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë*, ndërsa në bazë të përmbledhjes të vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë kandidatët e përzgjedhur kanë grumbulluar më së shumti pikë, konkretisht kandidati në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka mbledhur gjithsejtë 86.5 pikë, ndërsa kandidatja ka mbledhur gjithsejtë 67.8, duke u renditur kështu me numër rendor 1 dhe 2 në listën e kandidateve të suksesshëm, ndërsa ankuesi sipas kësaj liste është renditur me numër rendor 3 me gjithsejtë 67.2 pikë, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Komisioni Përzgjedhës me rastin e rekomandimit të kandidatëve të suksesshëm për emërim në shërbimin civil, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 40 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të*

madhi total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit nuk qëndron ngase duke ju referuar përgjigjeve të sakta të pyetjeve nga testimi me shkrim, të siguruara nga organi përkatës i punësimit, rrjedh se i njëjti nuk ka arritur të jap përgjigje të sakta në të gjitha pyetjet e testit të parapara si në çelësin e testit me shkrim, kështu që Kolegji konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e vlerësimit të testimit me shkrim të ankuesit, ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 37 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës gjë që pretendimi ankimor i tij në këtë drejtim është i pabazuar dhe jo ligjor.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën "Bashkëpunëtor profesional në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës" dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë në këtë proces, siç pretendon i njëjti, rrjedhimisht Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e zhvillimit të kësaj procedure ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore. Ndërsa, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr.39/2022 të datës 24.11.2022, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar ligjin material duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me A.nr.1149/2022.

Ardita Perçulcu-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi - Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.